



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
Drejtoria e Shërbimit, Kujdesit Social dhe Komunitar

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më ____ .7.2021

THIRRJE PUBLIKE

“Për përzgjedhjen e përfaqësuesit procedural për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë dhe dëshmitarë në procesin penal”

Bashkia Elbasan, bazuar në Udhëzimin e Përbashkët të MSHMS e MD nr.650 datë 13.9.2019 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e përfaqësuesve procedural për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë dhe dëshmitarë në procesin penal”, shpall thirrjen publike për të ftuar personat e interesuar për të ushtruar rolin e përfaqësuesit procedural për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë apo dëshmitarë në procesin penal.

Përfaqësuesit procedural kryejnë përfaqësimin procedural të fëmijëve në konflikt me ligjin, fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë në procesin penal në përputhje me parashikimet e ligjit nr.37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur".

Përfaqësuesit procedural ushtrojnë funksionet e tyre kur kërkohet nga organi procedues duke i shërbyer në çdo rast interesit më të lartë të fëmijës në konflikt me ligjin, fëmijës viktimë dhe dëshmitar në procesin penal.

Kriteret që duhet të plotësojë një individ për të qenë përfaqësues procedural janë:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë diplomën e studimeve të larta Bachelor dhe Master Shkencor ose Master Profesional në shkencë sociale, juridike, psikologji, sipas legjisllacionit në fuqi për arsimin e lartë, lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, brenda apo jashtë vendit, të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- c) të ketë minimalisht 2 vjet eksperiencë pune të mëparshme në çështje të mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;
- d) të ketë trajnime në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;
- e) të ketë njohuri mbi rregullat e zbatueshme për drejtësinë penale për të mitur;
- f) të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale dhune në familje dhe vepra penale kundër personit të kryera me dashje.

Thirrja publike do të qëndrojë e hapur për një periudhë prej 30 ditësh nga data e shpalljes.

Kandidatët e interesuar dorëzojnë pranë Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës në Bashkinë Elbasan të gjithë dokumentacionin e mundshëm që vërteton përmbushjen e kriterëve të përcaktuara më lart

si dhe deklarojnë adresat dhe të dhënat elektronike të kontaktit të tyre.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim, në adresën: shefki.lika@elbasani.gov.al:

- Curriculum Vitae (duke specifikuar përvojën e mëparshme në fushën e sipërpërmendur);
- Letër Motivimi (duke shprehur interesin si përfaqësues procedural për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë dhe dëshmitarë në procesin penal).

Përfaqësuesi procedural duhet të jetë i gatshëm të punojë pa pagesë. Përfaqësuesi procedural duhet të jetë i disponueshëm të ushtrojë funksionet e tij kur kërkohet nga organi procedues, duke i shërbyer në çdo rast interesit më të lartë të fëmijës në konflikt me ligjin, fëmijës viktimë dhe dëshmitar në procesin penal.

Kandidatët e paraqitur do të nënshtrohen vlerësimit në dy faza, nga Komisioni për Përzgjedhjen dhe Vlerësimin e Kandidatëve për të ushtruar rolin e përfaqësuesit procedural, i ngritur në bashki.

Afati për dorëzimin e dokumentacionit, pranë Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijës, është 5 ditë nga përfundimi i afatit 30 ditor nga shpallja e thirrjes.

Për informacion të mëtejshëm, ju lutem, mos hezitoni të kontaktoni në adresën: shefki.lika@elbasani.gov.al

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Aulona Bylykbashi